



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 79, datë 24.02.2020

PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
NR.26, DATË 16.01.2020

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 90 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në kushtet e plotësimit të numrit minimal të gjyqtarëve në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Korçë përmes caktimit pranë kësaj gjykate të një gjyqtari nga skema e delegimit me Vendimin e tij nr. 75, datë 20.02.2020, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Shkronja “b”, e pikës 1, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 26, datë 16.01.2020, “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në lidhje me nevojat e Gjykatës së Apelit Korçë”, riformulohet si më poshtë:

“b) Për çështjet sipas shkronjës “a” të këtij vendimi, në rastin kur për gjyqtarin në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë konstatohen, sipas ligjit, shkaqe papajtueshmërie në çështje të veçanta, trupi gjykues formohet me gjyqtarin që gjendet i renditur në listën e miratuar nga Këshilli. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur për gjyqtarët në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë konstatohen, sipas ligjit, shkaqe papajtueshmërie në çështje të veçanta. Në këtë rast, krahas gjyqtarit të caktuar për periudhën respektive, trupi gjykues formohet edhe nga gjyqtari/gjyqtarët që gjenden të renditur më pas në listën e miratuar nga Këshilli. Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Korçë merr masa për njoftimin në kohë të gjyqtarit/gjyqtarëve zëvendësues”.

2. Ky vendim i njoftohet gjykatave të apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR